

Nr. Prot., 4852/4 datë 11/12 / 2024

Nr. Prot., 371/2 datë 02/12 / 2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Lidhur ndërmjet Palëve

Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, institucion qendror publik (në vijim referohet si ISHMT) përfaqësuar nga Kryeinspektor, Z. Edison Konomi

dhe

Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit person juridik publik (në vijim referohet si DPS) përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Z. Riza Hasanaj.

Palët bien dakort të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi si më poshtë:

Neni 1 Qëllimi

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi, ka për qëllim të vendosë një bashkëpunim institucional ndërmjet *Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut* dhe *Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit*, në funksion të veprimtarisë së mbikëqyrjes së tregut dhe sigurisë së produkteve joushqimore.

Neni 2 Objekti

2. Palët bien dakord që objekti i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, konsiston në përcjelljen e informacionit nga DPS me kërkesën më parë me shkrim të ISHMT, lidhur

me Standarded e Shqiptare të Harmonizuara, që shërbejnë si referencë për prezumimin e konformitetit të produkteve jo-ushqimore, objekt i punës së ISHMT.

Neni 3

Baza ligjore

Baza ligjore për lidhjen e kësaj marrëveshjeje është:

- I. VKM nr. 36, datë 20.01.2016 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”, i ndryshuar;
- II. Ligji Nr.9870, datë 4.2.2008 “Për Standardizimin”, i ndryshuar.

Neni 4

Forma e bashkëpunimit

1. Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, me kërkesën më parë me shkrim të ISHMT, bën përditësimin e informacionit mbi standarded Shqiptare të Harmonizuara, të cilat lidhen me fushën e veprimtarisë së ISHMT.
2. ISHMT, për nevojat e saj, do të kërkojë në Katalogun e Standardeve Shqiptare, që jepet në faqen e internetit të DPS www.dps.gov.al, për çdo Standard që i nevojitet në veprimtarinë e saj të punës. Për të patur fizikisht dhe/ose elektronikisht Standardin/et e nevojshme ISHMT do të dërgojë në DPS, me shkrim ose nëpërmjet platformës së e-albania, kërkesën për blerje për çdo Standard Shqiptar me interes për të.
3. Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, gjatë aksesimit të informacionit mban në konsideratë respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe të drejtave të autorit, e cila i përket Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, duke mos i shpërndarë/përhapur/publikuar/shitur standardet.
4. DPS, në rastet e organizimit të trajnimeve dhe veprimtarive për standardizimin, fton ISHMT-në, të marrë pjesë në këto aktivitete.
5. ISHMT siguron pjesëmarrjen në Komitetet Teknike të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, për fushat që lidhen me veprimtarinë e saj, si palë e interesuar.

Neni 5

Zbatimi i marrëveshjes së bashkëpunimit

1. Zbatimi me sukses i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, do të varet nga komunikimi i

vazhdueshëm midis Palëve dhe shkëmbimi i informacionit në fushën e standardizimit.

2. Titullarët e palëve respektive, do të takohen në rast nevojë për sa i përket zbatimit të kësaj marrëveshje, në mënyrë që të rendisin prioritetet e bashkëpunimit brenda kësaj kornize dhe vazhdimin e tij.
3. Personat e kontaktit të secilës palë të përcaktuar në këtë marrëveshje, organizojnë takime çdo 3 muaj, për të diskutuar rreth aktiviteteve dhe bashkëpunimit në kuadër të kësaj marrëveshjeje dhe brenda 7 ditëve nga takimi, i dërgojnë titullarëve të institucionit që përfaqësojnë, një raport të përbashkët informues.
4. Palët angazhohen të takohen 1 herë në vit, për të diskutuar mbi zbatueshmërinë e marrëveshjes, planet dhe sfidat për të ardhmen në funksion të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional.

Neni 6

Komunikimi midis palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë komunikim të vazhdueshëm dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet si rregull në rrugë elektronike por nuk përjashtohen edhe mënyra të tjera të cilat çmohen të përshtatshme nga vetë palët. Në çdo rast të paraqitjes së një kërkesë, palët angazhohen të japin përgjigje brenda 10 ditëve pune.
2. Palët angazhohen të jenë të disponueshme në çdo kohë për komunikimin me njëra-tjetrën, me qëllim zbatimin në mënyrë efektive të marrëveshjes.
3. Secila Palë do të caktojë një përfaqësues si pikë kontakti për komunikimin midis institucioneve, në lidhje me çështjet që mbulohen nga kjo Marrëveshje Bashkëpunimi.
4. Në dhe për zbatim të kësaj marrëveshje, personat e kontaktit do të jenë:

- a. Për Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut

Drejtori i Drejtorisë Teknike

- b. Për Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit

Drejtori i Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Palët

Neni 7
Shqyrtimi i marrëveshjes

1. Institucionet nënshkruese rishikojnë vazhdimisht zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe e konsultojnë atë me synimin e përmirësimit dhe të zgjidhjes së problemeve të ndryshme që mund të dalin.
2. Palët duhet t'i përgjigjen propozimeve reciproke për rregullime ose ndryshime, jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së këtij propozimi.
3. Çdo ndryshim i kësaj marrëveshjeje do të aprovohet me shkrim nga palët. Specifikimet dhe ndryshimet në këtë marrëveshje rregullohen me anë të anekseve të cilat bëhen pjesë e kësaj marrëveshjeje pasi firmosen nga të dyja palët.

Neni 8
Dispozita Përfundimtare

1. Palët bien dakord që cdo mosmarrëveshje që lind ose mund të lindë gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, do të zgjidhet me mirëkuptimin nëpërmjet negocimit, nga ISHMT dhe DPS.
2. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi, do të hyjë plotësisht në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe mund të përfundojë me njoftimin me shkrim të secilës palë, 30 ditë pas këtij njoftimi.
3. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nënshkruhet në dy kopje në gjuhën shqipe, nga një kopje për secilën palë, e cila nënshkruhet me vullnet të lirë nga të dyja palët, pasi është lexuar dhe kuptuar me qartësi.

PALET

**INSPEKTORATI SHTETËROR I
MBIKËQYRJES SË TREGUT**

Edison KONOMI
KRYEINSPEKTOR



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
STANDARDIZIMIT**

Riza HASANAJ
DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Nënshkruar në Tiranë, më ____ / ____ / ____